



Data: 14.06.2018

Ref.: 659/180

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 56-të, të mbajtur më 11 Qershor 2018, mori:

### V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji “Heimerer”:

- Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore, MSc, 120 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji “Heimerer” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Menaxhimi i institucioneve dhe shërbimeve shëndetësore, MSc, 120 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore	MSc	120	Fehmi Ahmeti, Laura Pajaziti, Gazmend Bojaj

AKA ka organizuar vizitë në Kolegjin “Heimerer” më 21.09.2017, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik dhe Tatjana Gec.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 11 Qershor 2018 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegji “Heimerer”, dhe ka konsideruar se lista me bartësit e programit të ofruar nga institucioni ka qenë jo valide, si dhe raporti i hartuar nga ekspertët ka qenë jo bindës, dhe kështu ka votuar për mos akreditimin e programit Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore.

Anëtarët e KSHC-së kanë gjetur se Kolegji Heimerer ka ofruar lista të stafit me emra të njëjtë, siç është rasti i Prof. Gazmend Bojaj, i cili paraqitet si bartës edhe në programin Pedagogji Profesionale në Shëndetësi / Fushë Profesionale e Infermierisë BSc 180 ECTS. Kjo sipas tyre paraqet shkelje të kriterëve ligjore që

derivojnë nga Udhëzimi Administrativ i cili ka qenë në fuqi në kohën e vlerësimit., sipas të cilit një bartës i programit duhet të vendoset vetëm në një program studimi. Anëtarët e KSHC-së kanë konsideruar se raporti i ekspertëve ka mungesë të konsistencës dhe se përmbajta e raportit nuk korrespondon me rekomandimin përfundimtarë. Literatura e mangët në gjuhën shqipe, kurrikula jo e qartë, shpërndarja e orëve në mënyrë jo të përshtatshme, mungesa e librave të mjaftueshëm në bibliotekë për programin specifik janë disa elemente të cilat përmenden në këtë raport, e të cilat anëtarët e KSHC i kanë konsideruar si gjetje substanciale. Mungesa e stafit akademik të dedikuar në mënyrë specifike për këtë program është një element tjetër i rëndësishëm mbi të cilin janë bazuar anëtarët e KSHC-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji "Heimerer";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

